



BASHKIA PATOS

**PROJEKT
DOKUMENTI**

**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
FAZA E PARË 2027 - 2029**

Qershor 2026

PËRMBAJTJA

LOGO	1
1. HYRJE	4
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR	4
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	6
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË	7
2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE	7
2.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË PATOS	9
3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË PATOS	10
3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË	10
3.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJA E PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRFITUESIT	12
4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË PATOS 2027-2029	20
4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË PATOS NË VITET 2027-2029	21
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë PATOS për vitet 2027-2029	21
4.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë PATOS për periudhën 2027-2029	25
4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR	27
5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE	29
5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	30
5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	30
5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit	30
5.1.4 Informacione Bazë mbi Programin	30

Lista e Tabelave

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë PATOS	20
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit	21
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.	25
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike	24
Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III i COFOG)	24
Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	30
Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	30
Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	30
Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit	30
Tabela 9. Informacione bazë mbi Programin	30

Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MF	– Ministria e Financave
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto
SMBV	– Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjecare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifatat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së 2027-2029, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së 2027-2029, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësive vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetore të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027 planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësinë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor të vitit 2027 siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësinë vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe Buxheti Vjetor 2027 përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së dhe Buxhetit vjetor 2027 janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektive të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së . Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së dhe Buxhetit 2027 është specifikimi i Treguesve të Performancës specifik, matshëm, arritshëm, rëndësishëm dhe terma kohorë (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë .

Një element tjetër i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së dhe buxhetit vjetor 2026 është Hartimi i Kostove të planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për “Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, GMS i ngritur me urdhër të titullarit nr. 17, dt. 13.01.2026 vlerësoi dhe përcaktoi parashikimin afatmesëm të të ardhurave të cilat u miratuan me VKB nr. 14, dt. 25.02.2026. Duke u bazuar në udhëzimin nr.07, datë 27.02.2026 të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029”, GMS analizoi dhe përcaktoi “Tavanet Përgatitor të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 “ të cilat u miratuan me VKB nr. 18, datë 31.03.2026 dhe u konfirmuan nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr.432/1, datë 14.04.2026 . Kryetari miratoi udhëzimin e brendshëm nr. 02, datë 14.04.2026. Në vazhdim të udhëzimit të brendshëm GMS miratoi “ Kërkesat buxhetore , kërkesat buxhetore shtesë, relacionin e programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 Faza e Parë ” të hartuara sipas udhëzimit nr. 07, datë 27.02.2026 dhe sistemit të menaxhimit të buxhetit vendor .

2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë Patos

2.1 Situata e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

Burimi i Informacionit: Plan i Përgjithshëm Vendor .

Buxheti i vitit 2026-2028 është hartuar duke ju referuar Planit të përgjithshëm Vendor të njesisë tone, si dhe Planit të Investimeve Kapitale.

Buxheti i vitit 2026-2028 është hartuar duke ruajtur traditën e krijuar tashmë dhe duke marrë në konsideratë të gjithë mekanizmat e buxhetimit me pjesëmarrje siç janë, përcaktim i qartë i objektivave sektoriale, vendosje e prioriteteve mbështetur në nevojat dhe kërkesat që vijnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët si dhe mbajtja në nivele optimale e raportit kosto/rezultat duke u mbështetur në kosto reale të ofrimit të shërbimeve.

Zëri i qytetarëve në hartimin e Projekt-Dokumentit të PBA 2027-2029 .

Në zbatim të kalendarit u zhvilluan dëgjesa publike me Banorët e njesisë Administrative Zharrëz, me banorët e njesisë Administrative Ruzhdie si dhe në njësinë Administrative Patos.

Ky projekt dokument është hartuar duke përfshirë kërkesat prioritare të listuara në bazë të raportit mbi “Dëgjësata publike”, nga Këshilli Bashkiak. Kërkesat e dala nga këto konsultime janë përfshirë në kërkesat buxhetore sipas programeve, për ato objekte që mbulohen nga Bashkia kurse prioritetet që nuk mbulohen nga bashkia janë adresuar në institucionet përkatëse.

Bashkia Patos ka hartuar dhe miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor.

Hartimi dhe mbështetja e zhvillimeve në dokumenta planifikimi gjithëpërfshirës, sjell një frymë të re në menaxhimin e territorit, duke konsideruar jo vetëm tregun mobiluar, por dhe mbështetjen sociale dhe ekonomike të bashkisë, veçanërisht në ato raste kur synohet dhe një frenim apo kthim i trendeve aktuale të braktisjes.

Reforma territoriale e vitit 2015, krijoi bashkinë e re të Patosit duke bashkuar në një administrim të vetëm një bashki – Patosin dhe 2 komuna Zharrëz dhe Ruzhdien, të cilat sot janë njësiti administrativ të bashkisë. Aktualisht Bashkia e Patosit ka në perbërjen e saj 1(një) qytet dhe 18 (tetëmbëdhjetë) fshatra. Bashkia e Patosit bën pjesë në qarkun e Fierit dhe kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Fierit, në lindje me Bashkinë e Roskovecit dhe në jug me bashkinë e Mallakastrës.

Pjesa më verjore e territorit të bashkisë Patos, mbushet nga depozitime kuaternare kryesisht me prejardhje aluvila të cilat në pjesën e sipërme mbulohen nga depozitime kënetore. Në përgjithësi depozitimet kuaternare përfaqësohen nga argjila me shtresa rane si dhe me shtresa të rralla zhavorri.

Sektori i bujqësisë në punësim

Sektori i bujqësisë përballet aktualisht me problematika të shumta si: fragmentimi i lartë i tokës, mungesa e filierave prodhuese, infrastruktura e dobët, teknika dhe teknologjia ende e pa zhvilluar, mungesa e standardizimit dhe marketingut të produkteve, vështirësi në financim etj. Fakti se sektori i bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në ekonominë familjare, ka renditur zgjidhjen e problematikave të lartë përmendura si prioritet kombëtar.

Ndjeshmëria e prodhimit bujqësor ndaj luhatjeve klimatike dhe përfitimet modeste të gjeneruara, kanë për efekt integrimin e teknikave, teknologjisë dhe mekanizimin e prodhimit. Këto efekte synojnë një rritje të përfitimit ekonomik, falë ekonomisë së përshkallëzuar dhe reduktimin të kostos së prodhimit. Në këtë kuadër zhvillimi i pritshëm i sektorit të bujqësisë, do të ndikoj negativisht në nevojave për forcë punëtore, për shkak se me mekanizimin dhe përmirësimin e sistemit të prodhimit ka për pasojë të reduktoj forcën punëtore të nevojshme në këtë sektor. Riorientimi i të punësuarve në sektorin e bujqësisë, drejtë sektorëve të tjerë shfaqet si një tendence e ardhshme.

Sektori i industrisë në punësim

Sektori i industrial në nxjerrjen e naftës përfaqëson më shumë se 1/3 e të punësuarve në Bashkinë Patos, ku vlerat më të larta regjistrohen në Njësinë administrative Patos, me 41.9% të të punësuarve. Sektori i industrisë i cili bazohet në burimet natyrore energjetike, pritët të ketë një tendencë në rritje në të ardhmen, për shkak të zhvillimit të mundshëm të agroindustrisë, industrive të lehta prodhuese dhe përpunuese.

Sektori i shërbimeve në punësim

Sektori i shërbimeve punëson rreth 1/3 e të punësuarve të bashkisë Patos, duke u renditur si një sektor i rëndësishëm në tregun e punës. Njësia administrative Patos, është ajo që regjistron dhe pjesën më të lartë të të punësuarve në sektorin e shërbimeve. Ndikimi i sektorit të shërbimeve në tregun e punës, pritët të rritet në të ardhmen, për shkak të zhvillimit ekonomik të zonës.

2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë PATOS

Burimi i Informationit: PPV .

Nevojat për ndërhyrje në infrastrukturë dhe shërbime publike.

Problematikat e Sistemit Bujqësor që përfshijnë:

- fragmentimin e tokës bujqësore
- zënien e tokës nga ndërtimet informale
- prania e puseve të naftës dhe ndotja që shkaktohet prej tyre
- mungesa pika grumbullimi, përpunimi etj.
- mungesa në specialistë dhe në dije
- organizim i dobët i komunitetit të fermerëve
- nevoja për investime të vazhdueshme në infrastrukturën bujqësore, etj.

Në Sistemin Natyror problematika kryesore qëndron në transformimin e tij në tokë bujqësore duke ndikuar negativisht në ekosistemet territoriale. Pasuritë natyrore, si ujvara e Siqecës etj janë pak të njohura dhe pak të shfrytëzuara.

Problematikat e Sistemit urban mund të përmbliken:

- Shtrirje e madhe e banesës në territor duke rritur largësinë nga shërbimet.
- Shërbime të grumbulluara në Qytet
- Mungesë e tregjeve ushqimore apo industriale të strukturuar
- Mungesa në qendra komunitare e qendra për grupet vulnerabël të shpërndara në të gjithë Bashkinë.

3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë Patos

3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

Burimi i Informacionit: PPV

Ky dokument do të shërbejë si një instrument i përpjekjeve vendore për të bërë realitet të prekshëm ,

Qëllimin:

Qeverisje vendore e hapur, e drejtë dhe e përgjegjshme ndaj nevojave të komunitetit, sigurimi që të gjithë njerëzit të trajtohen në mënyrë të barabartë, me dinjitet dhe respekt, të lirë nga diskriminimi si parim bazë për ndryshime pozitive ,orientim për zhvillimin e ardhshëm bashkëjetesën e industrisë me bujqësinë, duke rritur cilësinë e jetës.

Prioritetet e vitit 2027-2029

1- Zhvillim Urban

- *Përmirësimi i aksesit rrugor.*
- *Zhvillimi i zonave periferike të qytetit.*
- *Krijimi i hapsirave publike dhe të gjelbëruara në qendër dhe periferi.*

2- Zhvillim Social –Ekonomik

- *Mbështetja e biznesit me politika fiskale për hapjen e vendeve të reja të punës.*
- *Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore.*
- *Mbështetja për krijimin e tregjeve rajonale për shitje.*

3- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi

- *Menaxhimi i mbetjeve urbane*
- *Menaxhimi i gjelbërimit të qytetit*
- *Eliminimi i ndotjes nga ujrat e zeza*
- *Mbështetje për rehabilitimin e shesheve nga facilitetet e abandonuara të industrisë së naftës ndër vite.*

4- Zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve

- *Mbështetje për rehabilitimin dhe krijimin e infrastrukturës së ujit*
- *Ndërtimi dhe mirëmbajtja e kanaleve të ujrave të zeza*
- *Mirëmbajtja urbane*
- *Ndërtim të një tregu bujqësor*
- *Ndërhyrjen në sistemin e kullimit, vaditjes, sistemin e rrugëve të parcelave,*
- *Shtimin e sipërfaqeve të pyjeve nepërmjet mbjelljes së sipërfaqeve të zhveshura*
- *Garantimin e shërbimit zjarrëfikës në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse.*

5- Zhvillimi i filialeve bujqësore e blegtorale

- *Përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes*
- *Organizimi i grupeve të prodhimit bujqësor e blegtoral, industrial dhe ofrimit të shërbimeve.*
- *Mbështetje e biznesit e fermereve për promovimin e produkteve bujqësore e blegtorale të zonës.*
- *Mbështetje e bashkëpunimit ndërmjet sektorit turistik dhe sektorit bujqësor e blegtoral.*
- *Paketa fiskale për thithjen e investitorëve të rendësishëm dhe punëdhënësve të mëdhenj, për zhvillimin e filialeve apo tregjeve bujqësore.*

Orientimi afatgjatë i bashkisë

Në zhvillimin e ardhshëm të territorit janë përcaktuar 3 drejtime kryesore të zhvillimit.

- *Zhvillimi ekonomik*
- *Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve*
- *Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe ambientale*

Këto drejtime përkojnë me disa objektiva strategjike:**A. Zhvillimi ekonomik**

Objektivi 1 *Një ekonomi e balancuar që krijon vende punë të kualifikuara dhe një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e sektorit primar, industrisë dhe shërbimeve.*

Objektivi 2 *Pushteti vendor bashkëpunues dhe transparent, nxitës i zhvillimit ekonomik me anë të politikave fiskale, nismave, promovimit dhe marketingut.*

B. Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve

Objektivi 3 *Lagje dhe fshatra që sigurojnë një mjedis të sigurtë, mundësi ndërveprimi social dhe shërbime të orientuara drejt mirëqenies së banorëve*

Objektivi 4 *Sigurimi i një varieteti tipologjik strehimi për të gjitha nivelet e të ardhurave, në të gjithë territorin, ofrimi i një larmie alternativash në zgjedhjen e mënyrës të jetesës dhe vendbanimit si përgjigje e ndryshimeve demografike.*

Objektivi 5 *Sigurimi i një rrjeti transporti dhe mobiliteti të sigurtë, të aksesueshëm, të qëndrueshëm.*

Objektivi 6 *Sigurimi i rrjeteve dhe struktura inxhinjerike që sigurojnë një ambient të shëndetshëm duke ulur impaktin mjedisor.*

C. Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe Mjedisore

Objektivi 7 *Ruajtja dhe rivlerësimi i elementeve të trashigimisë që janë themelet e qytetërimit dhe konfirmojnë të shkuarën.*

Objektivi 8 *Ruajtja e mjedisit natyror duke e integruar në aspektet argëtuese dhe sportive, me anë të krijimit të aksesit dhe mundësive për argëtim dhe shijim të natyrës.*

Objektivi 9 *Integrimi i elementëve natyrorë dhe kulturorë në jetën kulturore dhe artistike të bashkisë për të promovuar më tej territorin.*

Bashkia Patos ka respektuar të gjitha kërkesat ligjore për hartimin dhe paraqitjen në Këshillin Bashiak të të gjithë dokumentave strategjikë dhe buxhetorë, duke ndjekur të gjitha hapat dhe afatet e përcaktuara në ligj, për të siguruar një proces të plotë buxhetor.

3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsyet dhe Përfituesit

(Burimi i Informacinit: PPV / PZHS; Fishat e Projekteve, të tjera)

Burimi i informacionit: PPV; Fishat e projekteve, të tjera

- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi ekonomik i sektorit primar • Zhvillimi ekonomik i sektorit dytësor | Zhvillimi i filierave bujqësore eblegtorale
Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme
për funksionimin e Bizneseve
Rehabilitim i zonave ekzistuese
jofunksionale,
kthim në pole të rëndësishme |
| (INDUSTRI) | |
| <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi ekonomik i sektorit terciar | Zhvillim i shërbimeve në lagje dhe fshatra
Turizmi rural dhe agroturizmi si mbështetje
e zonave rurale.
Zhvillimi i shërbimeve mbështetëse pranë
pikave të interesit turistik. |
| (shërbimeve) | |
| <ul style="list-style-type: none"> • Infrastruktura në shërbim të zhvillimit | Krijimi i akseve tematike si promovues të
territorit ekonomik .
Përmirësimi i infrastrukturës ujitëse |
| <ul style="list-style-type: none"> • Marketimi (promovimi) i vlerave, traditave turistike | Rrjeti i Promovimi të destinacionit
dhe produkteve (brand lokal) .
Krijimi dhe promovimi i produkteve
dhe paketës turistike. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i arsimit profesional | Mbështetja e sistemit arsimor
Mbështetja e burimeve njerëzore aktive |
| <ul style="list-style-type: none"> • Mbështetje e biznesit | Mbështetja e bashkëpunimit
Lehtësira për bizneset |

Fishat e projekteve kryesore

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
Riualifikimi urban i sheshit para ish-bashkisë (Mustafa Matohiti)	Ky investim parashikon ndërhyrjen në përmirësimin e sheshit kryesor të qytetit duke e kthyer në një qendër funksionale si nga ana ndërtimore po ashtu edhe për zhvillimin e aktiviteteve të qytetit. Zona përfshin nga rruga Shpiragu deri tek sheshi “Riza Bregu” përgjatë rrugës Republika. Ndërhyrjet konsistojnë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e infrastrukturës nëntokësore, përmirësimin e fasadave të pallateve, riorganizimin e hapësirave sa më funksionale dhe efektive. Perfituesit nga ky projekt janë: -Gjithë banorët e qytetit të Patosit, kryesisht rreth 500 familje që banojnë në afërsi të qendrës Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 79,399,516 leke (përfshirë oponencën teknike, mbikqyrje dhe kolaudim) me financim si mëposhte: -Në vitin 2026: 500,000 lekë -Ne vitin 2027: 100,000 leke -Ne vitin 2028: 78,799,516 leke Kohezgjatja e Investimit: 3 Vite.
Rikonstruksioni i segmentit Patos-Mustafa Matohiti	Ky projekt parashikon ndërhyrjen për ndërtimi i rrugës Patos- Mustafa Matohiti, me pikë fillimi Bashkia Patos dhe pikë përfundimi kryqëzimi i fshatit Margëlliç. Ndërhyrja në këtë segment synon për të përmirësuar aksesin e banorëve të zonës. Segmenti ka gjatësi totale rreth 4.2 km me gjerësi variabël duke filluar nga 4m deri në 6m. Ky segment shërben për lidhjen e qytetit Patos me disa fshatra (Dukas Breg, dukas Velmish, Rrerës, Margëlliç, Lagjja Mustafa Matohiti) dhe shërben si rrugë lidhëse për fshatrat në Njësinë Administrative Ruzhdië. Punimet të cilat do të përfshihen në zbatimin e projektit janë: - Zgjerimin e rruges ekzistuese atje ku gjerësia është shumë e vogël dhe nuk ka akses shkëmbimi të lirshëm midis 2 mjeteve. -Shtrimi me asfaltobeton. -Punime shtresash -Prishja e mureve rrethues të ndërtuar në afërsi të trasesë së rrugës. Ndërtim i kanaleve të betonit në zonat problematika ku nuk janë të disiplinuara ujërat e bardha. - Ndriçimi rrugor në ato pjesë të segmentit që mungojnë. - Ndërtimi i kunetave të betonit. - Ndërtimi i trotuareve në zonat e banuara. - Ndërtimi i bankinave me stabilizant -Sistmime dherash. Perfituesit nga ky projekt janë: -Rreth 2000 familje Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 20,865,497 leke me financim si mëposhte: -Ne vitin 2029: 20,865,497 leke Kohezgjatja e Investimit: 1 Vit

Rikosntruskioni i rrugës Manxhari Gjinoqarë	Synimi i këtij projekti është ndertimi i rruges per ti sherbyer zones se banuar në fshatin Gjinoqarë, në lagjen Manxharaj. Gjatesia e kesaj rruge është rreth 500 ml. Rruga do te kete nje gjeresi 3.5m, bankinë me stabiliznat në të dyja anët. Punimet qe perfshin projekti jane si meposhte: - Gërmimi i shtresave rrugore ekzistuese -Shtrimi me asfaltobeton. -Punime shtresash -Prishja e disa mureve rrethuese Ndërtimi i kanaleve të dheut -Sistmime dherash. Perfituesit nga ky projekt jane: -Rreth 400 banore te zones Vlera totale e parashikuar per kete projekt sebashku me mbikqyrje dhe kolaudim: 12,181,835 leke me financim si meposhte: -Ne 2026: 8,181,835 leke -Ne 2027: 4,000,000 leke Kohezgjatja e Projektit: 2-Vite.
Rikosntruskioni i rrugës Argjinatura Belinë	Synimi i këtij projekti është ndertimi i rruges per ti sherbyer zones se banuar në fshatin Belinë, gjatë rrugës Argjinatura (në afërsi të shkollës Sotir Kola). Gjatesia e kesaj rruge është rreth 500 ml. Rruga do te kete nje gjeresi 3 m, bankinë me stabilizant në të dyja anët. Në dy pjesët anësore të segmentit rrugor janë ndërtuar kanalet vaditëse të veshura me beton. Punimet qe perfshin projekti jane si meposhte: - Gërmimi i shtresave rrugore ekzistuese -Shtrimi me asfaltobeton. -Punime shtresash -Pastrimi i kanaleve të betonit -Sistmime dherash. Perfituesit nga ky projekt jane: -Banorët e zonës Vlera totale e parashikuar per kete projekt sebashku me mbikqyrje dhe kolaudim: 3,336,345 leke me financim si meposhte: -Ne 2026: 1,400,000 leke -Ne 2027: 1,936,345 leke Kohezgjatja e Projektit: 2-Vite.
Rikonstruskioni i rrugës Rilindja Belinë	Ky projekt synon rikonstruksionin e rrugës Rilindja Belinë, i cili është i vetmi segment i cili lidh fshatin Belinë me njësinë Administrative Zharrëz dhe qyetetin Patos. Rikosntruskioni i këtij segmenti parashikon ndërhyrjen në trasenë rrugore, i cili për shkak të mungesës së drenazhit dhe ndërtimit të një bazamenti të qëndrueshëm, krijon carje të konsiderueshme. Ndërhyrjet konsistojnë në : - Ndërtim kasonete - Mbushje me gur të radhitur - Vendosje shtresës gjeotekstili

	- Punime gjurmimi - Punime shtresash - Punime asfaltobetonit - Punime sinjalsitike rrugore - Punime nëntokësore (vendosje tombino) - Bankinë më stabilizant Perfituesit nga ky projekt janë: -Banorët e zonës Vlera totale e parashikuar për këtë projekt sëbashku me mbikqyrje dhe kolaudim: 61,436,852 leke me financim si mëposhte: -Ne 2026: 10,000,000 leke -Ne 2027: 40,382,489 leke -Ne 2028: 11,054,363 leke Kohezgjatja e Projektit për financim: 3-Vite. (zbatimi i projektit është parashikuar 2 muaj)
• Përmirësimi i shtresës asfaltike në disa segmente në qytet	Synimi i këtij projekti është përmirësimi i shtresave asfaltike në disa segmente në qytet si: Rruga “Shpiragu (Pas bankës Raiffesisen), Rruga “Sulo Goxhaj”, Rruga “Heronjtë e Linasit”, Degësim i rrugës “Sulo Goxhaj”, Zgjerim i rrugës “Shëtitorja Republika” Punimet që përfshin projekti janë si mëposhte: - Skarifikim i shtresave asfaltike ekzistuese -Shtrimi me asfaltobeton. -Punime shtresash (Zgjerimi i rrugës Shëtitorja Republika) Perfituesit nga ky projekt janë: -Gjithë banorët e qytetit Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 28,135,883 leke me financim si mëposhte: -Ne 2026: 17,600,000 leke -Ne 2027: 10,535,883 leke Kohezgjatja e Projektit: 2-Vite.
• Rikosntruskioni i rrugës Kararaj, Ruzhdie	Synimi i këtij projekti është ndërtimi i rrugës për të shërbyer zonës së banuar në fshatin Ruzhdie, në lagjen Kararaj. Gjatesia e kësaj rruge është rreth 460 ml. Rruga do të ketë një gjeresi 3.0m, kanal betoni në njërin anë dhe shtresë betoni në anën tjetër për disiplinimin e ujërave të shiut. Punimet që përfshin projekti janë si mëposhte: - Gjurmimi i shtresave rrugore ekzistuese -Shtrimi me asfaltobeton. -Punime shtresash -Prishja e disa mureve rrethuese -Ndërtimi i kanaleve të betonit. - Ndërtimi i pusëve b/a -Sisteme dherash. Perfituesit nga ky projekt janë: -Banorët e zonës

	Vlera totale e parashikuar per kete projekt sebashku me mbikqyrje dhe kolaudim: 12,005,096 leke me financim si meposhte: -Ne 2026: 100,000 leke -Ne 2027: 7,135,386 leke -Ne 2028: 4,769,710 leke Kohezgjatja e Projektit: 3-Vite.
Rikosntruksioni i rrugës Saliaj, Grize Lënginas	Synimi i ketij projekti eshte ndertimi i rruges per ti sherbyer zones se banuar në fshatin Grizë Lënginas. Gjatesia e kesaj rruge eshte rreth 500 ml. Rruga do te kete nje gjeresi 3.5m, kanal betoni për disiplinimin e ujërave të shiut. Punimet qe perfshin projekti jane si meposhte: - Gërmimi i shtresave rrugore ekzistuese -Shtrimi me asfaltobeton. -Punime shtresash -Prishja e disa mureve rrethuese -Ndërtimi i kanaleve të betonit. - Ndërtimi i pusetave b/a -Sistemime dherash. Perfituesit nga ky projekt jane: -Banorët e zonës Vlera totale e parashikuar per kete projekt sebashku me mbikqyrje dhe kolaudim: 8,000,000 leke me financim si meposhte: -Ne 2026: 500,000 leke -Ne 2027: 7,500,000 leke Kohezgjatja e Projektit: 2-Vite.
Ndërtim KUZ dhe KUB (Bazë materiale)	Ky projekt parashikon blerjen e bazez materiale per sistemimin e ujerave te zeza dhe ujërave të bardha ne zonat ku kane probleme me kanalizimet dhe zgjerim rrjeti KUZ per zona informale. Nderhyrjen jane parashikuar ne zonat si: - Fshati Rreres - Fshati Verbas - Fshati Zharrëz - Dukas Çoban - Lagjja 29 Marsi tek Shëtpia e Bardhë Perfituesit nga ky projekt jane: - Banorët e zonave të përmendura Vlera totale e parashikuar per kete projekt: 1,800,000 leke me financim si meposhte: -Ne vitin 2026: 1,783,876 leke -Ne vitin 2027: 900,000 leke -Ne vitin 2028: 900,000 leke Kohezgjatja e Projektit: 3 Vite.
Krijimi i Parkut Rekreativ në Lagjen e Re	Ky investim parashikon krijimin e një hapësire të dedikuar shlodhëse dhe argëtuese për grupmoshat të ndryshme. Ky projekt është i bdarë në 2 zona ku Zona A parshikon ndërhyrjen në ndërtimin e fushave të basketboll, football, krijimi i tribunës në formë shkallare, rikonstruksioni i rrethimit të fushës. Ndërsa Zona B është parashikuar

	ndërtimi i një hapësire shlodhëse, duke krijuar hapësira të vecanta gjelbërimi, argëtimi, korsi bicikletash etj. Vendoshja e këtij projekti është në lagjen e Re në afërsi të Përroit. Ndërhryrjet që janë parashikuar janë: - Punime germimi - Punime betoni - Punime shtresash - Punime gjelberimi - Punime ndricimi - Punime sistemimi etj Perfituesit nga ky projekt janë: -Banorët e lagjes se Re dhe gjithë banorët e qytetit të Patosit Vlera totale e parashikuar per kete projekt: 41,146,479 leke me financim si meposhte: -Ne vitin 2026: 16,036,060 leke -Ne vitin 2027: 5,000,000 leke -Ne vitin 2028: 20,110,419 leke Kohezgjatja e Investimit: 3 Vite.
• Rikonstruksioni i shkollës Sotir Çapo dhe ndërtim i palestrës (oponencë+mbikqyrje dhe kolaudim)	Ky investim parashikon krijimin e kushteve të përshtatshme dhe bashkëkohore sipas standarteve për zhvillimin e procesit mësimor. Ndërhryrjet konsistojnë në veshjen e mureve të brendshëm dhe të jashtëm, dyshemesë, rrjetit elektrik, hidrosanitar, ngrohje-ftohje, sistemim i jashtëm dhe ndërtim i palestrës. Ndërhryrjet që janë parashikuar janë: - Punime veshje suvatimi i mureve dhe fasadave - Punime betoni - Punime shtresash - Punime sistemimi i jashtëm - Punime hidroizolimi i tarracës - Punime në rrjetin elektrik - Punime në rrjetin hidrosanitar - Punime për ndërtimin e palestrës etj Perfituesit nga ky projekt janë: -Fëmijët e Njesisë Administrative Zharrëz Vlera totale e parashikuar per kete projekt i cili eshte me financim nga Pushteti qendror dhe vendor, vetëm për pjesën që mbulon financimi nga Bashkia për bashkefinancim, oponencë, mbikqyrje dhe kolaudim: 30,946,988 leke si meposhte: -Ne vitin 2026: 7,847,381 leke -Ne vitin 2027: 23,099,607 leke Kohezgjatja e Investimit: 2 Vite.
• Rikonstruksioni i kopshtit ne lagjen e Re	Ky investim parashikon rikonstruksionin e godinës së kopshtit të cilësuar si Kopshti nr. 2, të ndosur në lagjen e Re ne rrugën Qerim Gropa. Për shkak të amortizimit gjatë kohës lind nevoja për rikonstruksionin total të objektit duke ndërhryrë në veshjen e mureve të brendshme dhe të jashtme, veshja e dyshemesë, ndërhryrje në rrjetin elektrik dhe hidronatuar, në sistemin e ngrohje-ftohjes. Ndërhryrjet në

	projekt parashikojnë adaptimin e katit përdhe në cerdhe për fëmijë. Ndërhryjet që janë parashikuar janë: - Punime veshje suvatimi i mureve dhe fasadave - Punime betoni - Punime shtresash - Punime sistemimi i jashtëm - Punime hidroizolimi i tarracës - Punime në rrjetin elektrik - Punime në rrjetin hidrosanitar, etj Perfituesit nga ky projekt jane: -Fëmijët e lagjës së Re Vlera totale e parashikuar per kete projekt: 50,247,318 leke me financim si meposhte: -Ne vitin 2026: 247,318 leke -Ne vitin 2027: 5,000,000 leke -Ne vitin 2028: 45,000,000 leke Kohezgjatja e Investimit: 3 Vite.
• Rikonstruksioni i Pallatit të Kulturës	Ky investim parashikon rikonstruksionin total të Pallatit të Kulturës duke ndërhryrë me strukturë përforcimi për të ruajtur identitetin e objekteve të cilat kanë vlerë historike për qytetin. Ky projekt synon rikonstruksionin e elementëve mbajtës të objektit duke rritur jetëgjatësinë e objektit. Objekti ndodhet në qendër të qytetit i cili shërben për zhvillimin e shumë aktiviteteve të cilat janë “Shfaqjet teatrale, Konferenca të ndryshme, Bibliotekë. Ndërhryjet konsistojnë në: - Përforcimin e elementëve mbajtës të objektit - Punime suvatimi të brendshëm dhe të fasadës - Punime të veshjës së dyshemesë - Punime elektrike - Punime hidroizolimi - Punime hidroteknike, etj Perfituesit nga ky projekt jane: -Gjithë banoret e qytetit Vlera totale e parashikuar per kete projekt: 155,356,457 leke me financim si meposhte: -Ne vitin 2028: 5,356,457 leke -Ne vitin 2029: 150,000,000 leke Kohezgjatja e Investimit: 2 Vite.
• Ndriçim rrugor (linja te reja)	Ky projekt parashikon investime ne shtim te ndricimit ne ato segmente qe jane ne erresire. Per mirembajtjen e rrjetit ekzitues jane parashikuar zevendesimi i llampave me gaz tashme te vjetersuara ne ato te teknologjise LED, zevendesimi i kablllove dhe paneleve te komandimit me te reja. Ne zonat rurale ku edhe furnizimi me energji elektrike eshte i veshite dhe me kosto, eshte parashikuar te instalohen impiante autonome me panele fotovoltaike. Prioritet u eshte dhene segmenteve të lëna në errësirë. - Rruga e Kalasë në Margëlliç

	- Lagjja Mustafa Matohiti Menza 3 - Rruga Belulaj, Zharrëz - Njësia Administrative Ruzhdie Perfituesit nga ky projekt jane: Gjithe banoret e qytetit Patos dhe Njesive Administrative Vlera totale e parashikuar per kete projekt: 38,300,000 leke me financim si meposhte: -Ne vitin 2027: 10,100,000 leke -Ne vitin 2028: 15,600,000 leke -Ne vitin 2029: 10,000,000 leke Kohezgjatja e Investimit:3 vite
• Ndërtim kuartalli të ri për varrezat në qytetin e Patosit	Ky projekt konsiston ne zgjerimin e siperfaqes aktuale te hapesires se varrezave publike te qytetit. Objekti ndodhet ne pjesen fundore te segmenit te quajtur “ Rruga e Varrezave”. Kuartalli i ri parashikohet te ndertohet ne kahun e djathte te rruges, ne pjesen veriore te varrezave aktuale. Punimet qe perfshin projekti jane si meposhte: • Punime germimi, mbushje dhe nivelim dherash • Punime mure mbajtese Perfituesit nga ky projekt jane: -Gjithe banoret e qytetit. Vlera totale e Kontrates per kete projekt: 13,960,000 leke me financim si meposhte: -Ne vitin 2026: 200,000 leke -Ne vitin 2027: 2,000,000 leke Brenda vleres se projektit perfshihet edhe vlera e mbikqyresit dhe kolaudatorit. Kohezgjatja e Projektit: 2-Vite
• Rikonstruksion i rrugëve të brendshme (Blerje bazë materiale asfaltobeton)	Synimi i ketij projekti eshte rikonstruksioni i segemnteve të brendshme të cilat përmirësojnë kushtet e segmenteve rrugore dhe përmirësimin e shtresave rrugore dhe lehtësimin e aksesueshmërisë së mjeteve. Punimet qe perfshin projekti jane si meposhte: - Gjermimi i shtresave rrugore ekzistuese -Shtrimi me asfaltobeton. -Punime shtresash -Sisteme dherash. Vlera totale e parashikuar per kete projekt: 27,000,000 leke me financim si meposhte: -Ne vitin 2029: 27,000,000 leke Kohezgjatja e Projektit: 1 Vit

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË PATOS 2027-2029

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë PATOS gjatë periudhës 2027-2029, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2026-2028, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2027-2029. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia.

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë PATOS

RAPORTI PBA9: INFORMACION MBI NJVQV/PROGRAMIN {shikoni Tabelat e PBA ne fund të materialit}.

4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë PATOS në vitet 2027-2029

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë PATOS për vitet 2027-2029

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme. Nuk pati ndryshime në të ardhurat e parashikuara duke mbetur të njëjtat krahasuar me fazën kaluar.

Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit

RAPORTI PBA2: PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE {shikoni Tabelat e PBA ne fund të materialit}.

4.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë PATOS

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

Të ardhurat e veta mbeten të pandryshuara nga ato të miratuara. Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qëndrore, këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore.”

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/ tarifët është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Patos, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjigjese për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimor.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Në hartimin e paketës fiskale të Bashkisë Patos janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh dhe të vogël, banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë.

Diskutimet publike janë organizuar në çdo njësi administrative dhe në qytet, për ndryshimet janë bërë takime konsultative gjithëpërfshirëse. Gjatë këtyre takimeve bashkëqytetarët, banorë, përfaqësues të grupeve të interesit, është diskutuar dhe janë bërë propozime për përmirësim.

Paketa fiskale e Bashkisë Patos, pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore / kufi, etj. sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

- Politikat lehtësuese në taksa.

- ❖ Takse banese zero për pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.
- ❖ Ulje e nivelit maksimal të lejuar prej 20 % nga referenca ligjore për taksapaguesit të cilët do të paguajnë taksën e tokës bujqësore brenda muajt Gusht.

- Politika lehtësuese në tarifa.

- ❖ Zero tarifë pastrimi bizneset e reja kur nr. i të punësuarve do të jetë mbi 10 persona.
- ❖ Zero tarifë pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi për fermerët e paisur me NIPT.
- ❖ Zero tarifë pastrimi/shërbimit komunitar për familjet që kanë persona me PAK, e veteranëve të luftës, e ndihmës ekonomike.
- ❖ Zero tarifë pastrimi/shërbimi komunitar për familjet e përndjekurve politik.

- ❖ Zero tarifë pastrimi/shërbimi komunitar për familjet e pensionistëve të vetmuar.

Sipas ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/2 bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës , mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve të sipas kritereve të përcaktuara me ligj.

Llogaritja e të ardhurave mbështetet në :

1. Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,
2. Ligjin nr. 9920 datë 26.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Patos nr. 82. datë 27.11.2024 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave për vitin 2025”
4. Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”,

A. Taksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

Paketa fiskale e Bashkisë Patos për këtë kategori është e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh (juridik) dhe të vogël (fizik), banorëve të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë.

A.2 Tarifat Vendore

Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:

a) tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave; b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve; c) tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet; ç) tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit; d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve; dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara në ligj; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore; ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.

B. Të ardhurat nga Menaxhimi i Pasurive Publike

Të ardhurat nga menaxhimi i pasurive publike përfshijnë të ardhurat e gjeneruara nga dhënia me qira e tokës bujqësore, pronës, tokës dhe pajisjeve palëve të treta.

C. Të Ardhura të Tjera të Veta

Të ardhurat e tjera përfshijnë ato të gjeneruara nga: pozicionet aksionare të bashkisë; ndëshkimet dhe gjobat; grante nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga qeveritë e huaja; etj.

4.1.1.2 Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerale. Informacioni për këto të ardhura është paraqitur në këtë nën-seksion.

A. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera.

B. Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përftojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë.

C. Renta Minerare

Çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për këtë fushë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi/nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku kryhet aktiviteti marrin 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare.

- D. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

4.1.1.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

4.1.1.4 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë PATOS për periudhën 2027-2029

Tabela 3, paraqet shpenzimet faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve gjatë periudhës 2024 deri në 2029.

Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.

RAPORTI PBA3: SHPENZIMET E NJVQV DHE PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK {shikoni Tabelat e PBA ne fund të materialit}.

Tabela 4, paraqet shpenzimet totale faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilin program buxhetor për periudhën 2024-2029.

Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike

RAPORTI PBA5: SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT DHE KLASIFIKIMIT EKONOMIK {shikoni Tabelat e PBA ne fund të materialit}.

Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III i COFOG)

RAPORTI PBA4: SHPENZIMET E NJVQV SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL (NIVELI I, II, III I COFOG) {shikoni Tabelat e PBA ne fund të materialit}.

4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR

Përmbledhje e çështjeve kryesore të investimeve publike (prioritare);

Projektet:	Ndërhjert dhe problematikat:
1. Rikonstruksion i rrugës “Manxhari”, Gjinoqare	Rruga e cila do ti nënshtrohen rikonstruksionit ndodhet në Njësinë Administrative Ruzhdie dhe është rruga kryesore e fshatit Gjinoqarë. Rruga ka një gjatësi prej $L=1000\text{m}$ dhe gjerësi $b=3\text{m}$ dhe është pothuajse totalisht e amortizuar duke vështirësuar qarkullimin e banorëve për kryerjen e aktiviteve të tyre të përditshme. Prej vitesh nuk janë bërë ndërhjert në këtë segment pervec shtrimit të saj me rërë bituminoze i cili është një material që nuk siguron jetëgjatësi dhe amortizimi i rrugës deri më sot është kthyer në një problematikë për banorët e zonës. Punimet që përfshin ky projekt: Projekti parashikon ndërhjert në të gjithë gjatësinë e rrugës “Manxhari” dhe degezimet e saj. Bazuar në karakteristikat e ndërhjertve në trupin e rrugës dhe tipin e profilin terthor, segmentet rrugore do të trajtohen si me poshtë: <u>Aksi kryesor i rrugës:</u> Elementët përbërës kryesor të këtij segmenti janë karrexhata, e cila ka një gjërësi asfalti prej 3 m ose 300 cm karrexhate në varësi të hapësirës së lejuar urbane dhe fluksit të mjeteve në zonë.<u><i>Referuar paketës së shtresave rrugore, aksi kryesor dhe degëzimet përkatëse do të pajisen me paketën e shtresave:</i></u> <i>*Shtrese Cakelli 15 cm * Stabilizant 10 cm *Binder 5 cm* Asfaltobeton 3 cm.</i> Përfituesit nga ky projekt janë: - Banorët e zonës.
2. Rikonstruksion i rrugës “Argjinatura”, Belinë	Rruga e cila do ti nënshtrohet rikonstruksionit ndodhet në fshatin Belinë. Aksi kryesor i rrugës ka patur ndërhjert të pjesshme përgjatë kohës, ku sipërfaqja e rrugës është trajtuar me rërë bituminoze, e cila aktualisht ndodhet në gjendje të amortizuar. $L=900\text{ m}$ Punimet që përfshin ky projekt: Projekti parashikon ndërhjert në të gjithë gjatësinë e aksit kryesor të rrugës “Argjinatura”. Bazuar në karakteristikat e ndërhjertve në trupin e rrugës dhe tipin e profilin terthor, segmentet rrugore do të trajtohen si me poshtë: <u><i>Referuar paketës së shtresave rrugore, aksi kryesor dhe degëzimet përkatëse do të pajisen me paketën e shtresave:</i></u> <i>*Shtrese Cakelli 15 cm, *Stabilizant 10 cm, *Binder 5 cm, *Asfaltobeton 3 cm.</i> Përfituesit nga ky projekt janë: Banorët e zonës.
3. Rikonstruksion i rrugës “Rilindja”, Belinë	Segmenti rrugor “Rilindja”, i cili ka nevojë për ndërhjert ndodhet në fshatin Belinë dhe është aksi kryesor i cili e lidh këtë fshat me qytetin e Patosit, Fierit dhe qendrën e Njësisë Zharrëz. Për shkak të mungesës së ndërhjertve për një kohë të gjatë, segmenti i kësaj rruge me gjatësi rreth 1000 m ndodhet në gjendje tëjet të amortizuar, ku çarjet e trupit të rruges vazhdojnë të avancojnë. Segmenti me nevojë urgjente për ndërhjert shtrihet në distance rreth 200 m përpara ures së Belinës dhe

	rreth 800 m pas ures, ne drejtim te qytetit te Fierit. Amortizimi i ketij aksi eshte bërë problem për qarkullimin e banorëve të zonës, fermerëve, aktivitetet tregëtare si dhe burim aksidentesh vecanerisht gjate nates ku mungesa e ndricimit rrugor rrit rrezikshmerine qarkullimit ne kete rruge. Punimet që përfshin ky projekt: Projekti parashikon ndërhyrjen në një segment me gjatesi rreth 1000 ml te rruges Rilindja. Gjeresia mesatare e rruges ekzistuese eshte 5.5m. Nderhyrjet konsistojne ne skarifikimin e shtreses ekzistuese asfaltike me makineri pergjate gjithe gjatesise dhe me pas germimin e nenshtresave te rruges deri ne nje thellesi prej 50-60cm. Pas germimit te siperfaqes rrugore ne nje gjeresi prej 700 cm dhe thellesi 50-60 cm, do te behet cilindrimi i kasonetes me rrul me qellim krijimin e nje siperfaqe uniforme dhe kompakte. Bazamenti i rruges do te trajtohet me nje shtrese gjeotekstili me gramature 180g/m2. Shtresa e gjeotekstilit do te vendoset mbi kasoneten e cilindruar dhe do te lihet jashte kasonetes ne nje gjatesi rreth 1.5 m ne secilin kah, te mjaftueshme per tu palosur deri nen shtresen e stabilizantit. Mbi gjeotekstil do te hidhet nje shtrese zhavor lumi me trashesi 20 cm dhe do te behet cilindrimi i saj. Mbi shtresen e cilindruar te zhavorit do te procedohet me hedhjen e paketes se shtresave rrugore si me poshte: 1. Shtrese cakelli mbeturine kave t=20 cm 2. Shtrese stabilizanti t=10 cm 3. Shtrese binderi me granil gur kave t=6cm 4. Shtrese asfaltobetoni me granil gur kave t=4 cm Përfituesit nga ky projekt janë: - Banorët dhe bizneset që ushtrojnë aktivitetin në këtë zonë.
4. Rikonstruksion i kopështit nr. 2	Objekti aktualisht frekuentohet nga rreth 50 fëmijë të grupmoshave të ndryshme dhe kushtet në të cilat ato qëndrojnë nuk plotësojnë as kërkesat minimale optimale për zhvillimin e mësimdhënies. Në pamje të parë vihet re fasada e amortizuar, mungesa e sistemimit të hapësirave dhe oborrit përreth, amortizimi i dyerve dhe dritareve të jashtme si dhe shumicës së elementeve të tjerë të brendshëm të objektit. Disa nga problematikat kryesore kanë të bëjnë me dëmtimin e suvatimeve të jashtme, mos shfrytëzimi i të gjitha ambjenteve për shkak të amortizimit të tyre qoftë jashtë ose brenda. Lagështia është një tjetër faktor e cila ka ndikuar dhe në uljen e frekuentimit nga fëmijët për shkak dhe të problematikave shëndetësore që sjell. Gjithashtu vihet re mungesa e sistemit në ngrohje-ventilimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit. Të dhënat teknike: Kati pare: Sip=160m² Kati dytë: Sip=160m² Punimet që përfshin ky projekt: Projekti parashikon ndërhyrjen në të gjithë kompleksitetin e godinës. Janë parashikuar ndërhyrje në disa kategori punimesh pa ndryshuar strukture dhe funksionin. Ky rikonstruksion do të jetë në fasadë dhe i brendshëm. Do të ketë një riorganizim të hapësirave dhe dhomave. Përfituesit nga ky projekt janë:- Bashkia Patos

5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE

Buxheti total i Bashkisë Patos aktual menaxhohet sipas 17 programeve të shpenzimeve nga të cilat dy programe janë për fondin rezerve dhe kontigjencë ndërsa sipas metodologjisë së re do të kemi 6 programe buxhetore ku një program do të jetë për fondin Rezervë dhe Kontigjencë. Planet e shpenzimeve që lidhen me performancën për secilin vit të PBA-së, për secilin nga programet e shpenzimeve të Bashkisë.

Buxheti i vitit 2027-2029 është hartuar duke ju referuar Planit të përgjithshëm Vendor të njesisë tonë , si dhe Planit të Investimeve Kapitale.

Buxheti i vitit 2027-2029 është hartuar duke ruajtur traditën e krijuar tashmë dhe duke marrë në konsideratë të gjithë mekanizmat e buxhetimit me pjesëmarrje siç janë, përcaktim i qartë i objektivave sektoriale, vendosje e prioriteteve mbështetur në nevojat dhe kërkesat që vijnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët si dhe mbajtja në nivele optimale e raportit kosto/rezultat duke u mbështetur në kosto reale të ofrimit të shërbimeve.

Janë planifikuar 6 programe buxhetore nga i cili 1 program është i dedikuar për Fondin Rezervë dhe Kontigjencë.

Kështu:

- Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë Patos sipas Tavanëve të PBA-së 2027-2029 është bërë duke marrë si bazë kufirin e shpenzimeve të vitit 2026 , investimet që janë parashikuar në PBA 2027-2029 si dhe projektet e miratuara duke përfshirë dhe ato me bashkëfinancim. Ka një rritje prej 1.4 % në vitin 2027 duke marrë si bazë kufirin e shpenzimeve të vitit 2026 , 1.3 % për vitin 2028 duke marrë si bazë kufirin e shpenzimeve të vitit 2027, 1.3% për vitin 2029 duke marrë si bazë kufirin e shpenzimeve të vitit 2028.
- Shtesa që vjen për rritjen e nivelin të pagave do mbulojë mbajtjen e një standardi të qëndrueshëm të pagës në bazë të funksionit dhe nivelit.
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2027 duke marrë si bazë vitin 2026 është rritur me 2 % , për vitin 2028 është e njëjtë me vitin 2027, ndërsa për vitin 2029 ka një rritje në vlerën 1 % krahasuar me vitin 2028.
- Shtesa nga transferata e pakushtëzuar dhe shtesa nga rritja e të ardhurave për çdo vit që është dhe pjesa e pashpërndarë, është shpërndarë për investime të cilat prekin çdo program dhe indeksimin e pagave.
- Bashkia Patos vijon me politikat e saj për kryerjen e investimeve,
- Në aspektin fiskal, Bashkia me këtë buxhet synon mbajtjen e pandryshuar të taksave dhe tarifave vendore ose me rritje të lehtë për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, si dhe vazhdimin e politikave lehtësuese ose përjashtuese nga pagesa e taksave për kategoritë në nevojë.
- Synon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore duke forcuar strukturat dhe mirëadministrimin duke rritur bazën e taksapaguesve.
- Garanton transparencën në përdorimin e fondeve publike si dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit të shpenzimeve publike.

Modeli i Parashikimit Financiar për vitet 2027-2029 mbështetet në :

- *Parashikimin e Shpenzimeve*; parashikimi i shpenzimeve bëhet për çdo kategori të shpenzimeve aktuale. Çdo shpenzim parashikohet në bazë të parashikimit të personelit, operimit dhe mirëmbajtjes dhe shpenzime të tjera;
- *Parashikimin e të Ardhurave*; parashikimi i të ardhurave bëhet në të njëjtën mënyrë si parashikimi i shpenzimeve duke ju referuar çdo takse dhe tarifë, të cilat analizohen në hollësi;
- *Treguesit e Buxhetit Total*; paraqesin një gërshetim të të gjitha burimeve të financimit dhe shpenzimeve gjatë një viti buxhetor.

Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

RAPORTI PBA3: SHPENZIMET E NJVQV DHE PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK
 {shikoni Tabelat e PBA ne fund të materialit}.

5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Ky nënseksion ofron informacion mbi planet e performancës së programit. Deklarata e Politikës së Programit është paraqitur në Tabelën 6, duke artikuluar qëllimet e politikës së programit, objektivat e politikës së programit dhe treguesit përkatës të performancës për çdo vit të PBA-së.

Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

RAPORTI PBA6: DEKLARATA SË POLITIKËS SË PROGRAMIT {shikoni Tabelat e PBA ne fund të materialit}.

5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Ky nënseksion, ofron informacion mbi planet e ofrimit të shërbimeve të programeve dhe kostot përkatëse. Për secilin Objektiv të Politikës së Programit, paraqitet informacion për produktet që do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave. Informacioni për produktet përfshin emrin e produktit, përshkrimin e produktit, sasinë e planifikuar, shpenzimet totale dhe shpenzimet për njësi të produktit.

Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

RAPORTI PBA7: SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT {shikoni Tabelat e PBA ne fund të materialit}.5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit

Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit

RAPORTI PBA8: PROJEKTET E INVESTIMEVE {shikoni Tabelat e PBA ne fund të materialit }

5.1.4 Informacione Bazë mbi Programin

Ky seksion i dokumentit paraqet të dhëna dhe statistika specifike të programit, që mund ta ndihmojnë lexuesin të kuptojë më mirë profilin dhe kontekstin e programit.

Tabela 9. Informacione bazë mbi Programin

RAPORTI PBA9: INFORMACION MBI NJVQV/PROGRAMIN {shikoni Tabelat e PBA ne fund të materialit}.

BASHKIA PATOS

PBA 2027-2029

Sekretare e GMS

KORDINATORI I GMS

NËPUNËSI AUTORIZUES

Drejtore Finance

Nënkryetare

KRYETARI

Mimoza Shtëmbari

Ina Sauli

Fation Duro

